



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:136830
Datë: 24.12.2024
Numri i dokumentit: 06647903

C-II-18-0046-C0001 - C0002

- 1. C0001- M P fshati P, Graçanicë**
- 2. C0002-L I fshati P, Garacanice**

Ankueset

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit (NSH “Gërmia)Rr.Dritan Hoxha nr.55 Lakrishtë Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare te Privatizimit (DHPGJS) gjyqtarja Diellza Hoxha me date 23 dhjetor 2024 lëshon këtë:

AKTVENDIM

- 1. Ankesat e paraqitura nga ankuesja C0001-M P dhe ankuesja C0002 L I hedhen poshtë si te pa pranueshme .**
- 2. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankueset.**

Rrethanat procedurale

Me 06.06.2018 ankueset kane parashtruar ankesë në DHPGJS për mospërfshirjen e tyre ne në listën përfundimtare te punetorëve te cilet kanë drejtë në një pjesë te 20 %. Ato theksojn se ka ofruar të gjithë dokumentacionin AKP-s,në bazë të të cilit ato cekin se kane qenë punëtore te NSH “Gërmia ” qysh nga fillimi deri ne privatizim.. Gjykates i propozojn që ankesat të aprovohn dhe të regjistrohen në Listën përfundimtare të punetorëve te cilet kane te drejte ne një pjesë të 20%.

Ankuesja, **C0001 M R** në mbështetje të ankesës ka dorëzuar.

- Kopjen e letërnjoftimit ,
- Kopjen e vendimit të marrdhënies së punës nr.374 të datës 21.10.1996,
- Kopjen e ekstraktit të lindjes

Kërkon nga Gjykata që ta marrë në konsideratë kërkesën e saj dhe të aprovojë pozitivisht.

Dhoma e Posaçme ia dërgoi AKP-së ankesën e ankueses.

Më 28 qershor 2018 AKP-ja në përgjigjen e saj deklaroi se ankuesja ka lëshuar afatin ligjor për parashtrimin e ankesës në bazë të nenit 10.6 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Dita e fundit për parashtrimin e ankesës ka qene më 07.01.2012 ndërsa ankesa është parashtruar më 06.06.2018. Ankuesja madje nuk mund të paraqes as kërkesë për përsëritjen e procedurës. Sipas nenit 130.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore afati për parashtrimin e një kërkesë të tillë është 60 ditë nga dita e nxjerrjes së vendimit.

Andaj i propozon gjykatës që ankesën ta hedhe poshtë si të pa pranueshme.

Ankuesja **C0002 L I** në mbështetje të ankesës ka dorëzuar :

- Kopjen e librezës së punës
- Kopjen e vendimit për pushim vjetor nr.352 të datës 20.06.1997.

Kërkon nga Gjykata që ta marrë në konsideratë kërkesën e saj dhe të aprovojë pozitivisht.

Dhoma e Posaçme ia dërgoi AKP-së ankesën e ankueses.

Më 28 qershor 2018 AKP-ja në përgjigjen e saj deklaroi se ankuesja ka lëshuar afatin ligjor për parashtrimin e ankesës në bazë të nenit 10.6 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Dita e fundit për parashtrimin e ankesës ka qene më 07.01.2012 ndërsa ankesa është parashtruar më 06.06.2018. Ankuesja madje nuk mund të paraqes as kërkesë për përsëritjen e procedurës. Sipas nenit 130.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore afati për parashtrimin e një kërkesë të tillë është 60 ditë nga dita e nxjerrjes së vendimit.

Andaj i propozon gjykatës që ankesën ta hedhe poshtë si të pa pranueshme.

Arsyetim ligjor

Ndërmarrja Shoqërore (NSH) “Gërmia” është privatizuar më 20 maj 2008, por në bazë të dokumentacionit të lëshuar nga AKM-ja, institucioni i cili e ka administruar paraprakisht NSH-në, likuidimi i Ndërmarrjes Shoqërore “Gërmia” kishte filluar më 05.07.2007. Afati i fundit

kohor për të parashtruar një ankesë pranë Dhomës Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës ka qenë 07.01.2012.

Në lidhje me Ankesat e parashtruara për përfshirjen në listën e përfituesve të 20 % apo kundërshtimin e listës përfundimtare, Dhoma e Posaçme ka vendosur me Aktgjykim SCEL-11-0070-C0001-C0115 të nxjerrur më dt. 24.02.2015.

Ne këtë aktgjykim ankesa e ankueses nën C0002 L I ishte refuzuar .

AKP-ja pretendon se ankesat janë parashtruar pas afatit kohor.

Procedura për parashtrimin e ankesës në Dhomën e Posaçme përcaktohet në nenin 10.6 (a) të Rregullores së UNMIK-ut (e ndryshuar), e cila thotë: “Ankesa duhet të dorëzohet në Dhomën e Posaçme brenda 20 ditëve pas shpalljes përfundimtare në media nga Agjencia, në bazë të paragrafit 10.3, të listës së të punësuarve me të drejta legjitime”.

Gjykata konstaton se ankesat janë parashtruar më 06.06.2018 pas afati të lejuar me ligj madje edhe pas afati të lejuar për parashtrimin e kërkesës për përsëritjen e procedurës.

Përcaktimi i afateve ligjore nga ligjvënësi brenda të cilit duhet ndërmarrë një veprim bëhet me qëllim të zhvillimit të një procedure më të shpejtë dhe më të drejtë, që janë parime të përgjithshme për të gjitha procedurat gjyqësore në të kundërtën do të cenonte sigurinë juridike.

Andaj Ankesat duhet hedhur poshtë si të pa pranueshme .

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do të mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.2 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, punëtorët lirohen nga pagesa e taksës gjyqësore.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Diellza Hoxha _____
Gjyqtare



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

C-II-18-0046

- 1. C0001- M P** selo P ,Gračanica
- 2. C0002-L I** selo P Gračanica

Žalilje

Protiv

Tužena

Kosovska Agencija za Privatizaciju (KAP) ,ul. "Dritan Hođa" br.55, Priština

Posebna Komora Vrhovnog Suda Kosova za pitanja koja se odnose na Kosovsku Agenciju za Privatizaciju (PKVSK), sudija Diellza Hoxha, je dana 23 decembra 2024. godine, donela ovo;

REŠENJE

- 1. Žalbe podnete od strane M P-C0001 i L I-C0002 odbacuju se kao neprihvatljive**
- 2. Ne određuju se sudske takse .**

Činjenične i proceduralne okolnosti

Dana 06.06.2018. godine žalilje su podnele žalbu pri PKVSK zbog neubohvatanja u konačnu listu radnika koji imaju pravo na 20% udjela od privatizacije . One su KAP-u dostavile svu dokumentaciju na osnovu koje su izjavile da su zaposlene u DP "Germia " od početka pa do privatizacije. Predložile su sudu da se njihove žalbe usvoje i upišu u konačan spisak radnika koji imaju pravo na 20% udela u prihodu od privatizacije .

Žalilja C0001 M P je u prilog žalbe dostavila :

- Kopiju lične karte ,
- Kopiju izvoda rodenih ,
- Kopiju rešenja o random odnosu br.374 dana 21.10.1996 godine .

Žalilja predlaže da Sud razmotri njen zahtev i da ga pozitivno usvoji.

Posebna Komora je poslala KAP- žalbu.

Dana 28 juna 2018 godine, KAP u svom odgovoru izjavljuje da je žalija propustila zakonski rok za podnošenje žalbe na osnovu člana 10.6 Uredbe UNMIK-a 2003/13. Poslednji dan za podnošenje žalbe bio je 07.01.2012. godine, dok je žalba podneta 06.06.2018 godine. Prema članu 130.3 Zakona o Pravnomo Postupku, rok za podnošenje takvog zahteva je 60 dana od dana donošenja rešenja. Stoga predlaže sudu da žalbu žalilje odbaci kao nedozvoljenu.

Žalilja **C0002 L I** je u prilog žalbe dostavila :

- Kopiju radne knjižice ,
- Kopiju rešenja o godišnjem odmoru br.352 dana 20.06.1997 godine .

Žalilja predlaže da Sud razmotri njen zahtev i da ga pozitivno usvoji.

Posebna Komora je poslala KAP- u žalbu.

Dana 28 juna 2018 godine, KAP u svom odgovoru izjavljuje da je žalija propustila zakonski rok za podnošenje žalbe na osnovu člana 10.6 Uredbe UNMIK-a 2003/13. Poslednji dan za podnošenje žalbe bio je 07.01.2012. godine, dok je žalba podneta 06.06.2018 godine. Prema članu 130.3 Zakona o Pravnomo Postupku, rok za podnošenje takvog zahteva je 60 dana od dana donošenja rešenja. Stoga predlaže sudu da žalbu žalilje odbaci kao nedozvoljenu.

Pravno obrazloženje

Društveno preduzeće (DP) "Germia" je privatizovano 20. maja 2008. godine, ali na osnovu dokumentacije koju je izdala KPA, institucija koja je ranije upravljala DP-om, likvidacija DP "Germia" je počela 05.07.2007godine . Rok za podnošenje žalbe Posebnoj Komori Vrhovnog Suda Kosova bio je 07.01.2012.

U vezi sa podnetim žalbama za obuhvatanje na konačnu listu za 20%, ili protivljenje konačne liste.

Posebna Komora je odlučila presudom SCEL-11-0070 od 24.02.2015 godine.

Ovom presudom odbijena je žalba žalilje pod C0002 L I.

KAP tvrdi da je žalba podneta nakon isteka roka.

Procedura za podnošenje žalbe Posebnoj Komori je navedena u članu 10.6(a) Uredbe UNMIK-a (sa izmenama), koja kaže: „Žalba se mora podneti Posebnoj Komori u roku od 20 dana nakon konačnog medijskog saopštenja od Agencija, na osnovu stava 10.3. spiska zaposlenih sa legitimnim pravima“.

Sud nalazi da su e žalbe podnete 06.06.2018. godine nakon isteka zakonom predviđenog roka, pa i nakon isteka roka za podnošenje zahteva za ponavljanje postupka.

Određivanje zakonskih rokova od strane zakonodavca u kojima se neka radnja mora preduzeti vrši se u cilju razvijanja bržeg i pravednijeg postupka, koji su opšti principi za sve sudske postupke, u suprotnom bi se narušila pravna sigurnost.

Dakle, žalbe se moraju odbaciti kao neprihvatljive.

Sudski troškovi

Na osnovu člana 62.5 Zakona o Posebnoj komori, svaka stranka snosi svoje troškove. U skladu sa članom 13.2 Administrativnog uputstva za ujednačavanje pravosudnih poreza, Sudskog saveta Kosova (SSK) br. 01/2017, od 22. marta 2017. godine, radnici su oslobođeni plaćanja sudske takse.

Pravni savet

Protiv ovog resenja može se podneti pismena žalba Apelacionom veću PKVS u roku od 15 dana od dana prijema ovog resenja . Žalba se mora podneti u skladu sa članom 9 stav 6 Zakona o PKVS.

(potpisano)
Diellza Hoxha, Sudija